

DRITAT E DIASPORËS

KEDS trajtoi me
prioritet kërkesat
e Diasporës për
Lidhje të Reja

KEDS
shënoi
8-vjetorin

ENERGY

Përmbajtja / Contents

SHËRBIME

4-9 Dritat e Diasporës / *Diaspora lights*

SHËRBIME

10-12 Si dhe kur bëhet rikyçja në KESCO / *How and when is made the reconnection to KESCO*

ENERGY

14-16 KEDS trajtoi me prioritet kërkesat e Diasporës për Lidhje të Reja gjatë verës / *KEDS prioritized diaspora requests for new connections during the summer*

EDUKIM

18-20 Tetë me një - Goneta dhe Arditi / *Eight with one - Goneta and Ardit*

NGJARJE

22-27 Ngjarjet që karakterizuan KEDS dhe KESCO / *Events that categorized KEDS and KESCO*

ENERGY

28-29 KEDS shënoi 8-vjetorin e operimeve në Kosovë / *8 years of KEDS operations in Kosovo*

INVESTIME

30-33 Transformimi i Kosovës në qytete pa tela / *Kosovo transformation into cities without electricity cables*

KULTURA

34-40 KEDS/KESCO dhe artistët / *KEDS/KESCO and artists*

INTERVISTA

42-46 Intervistë me inxhinieren pioniere të KEDS / *Interview with the pioneer engineer of KEDS*

COVID 19

48-51 Pandemia e Vetonit në tri akte / *Veton pandemic in three acts*

BRENDË KEDS

52-56 Aty ku nis gjithçka / *Where it all starts*

SPORT

57-58 Shqiptarët e thanë fuqishëm fjalën e vet në euro 2020 / *Albanians strongly said their word at euro 2020*

*Shënim / Note

Shqip / English

—

—

DRITAT E DIASPORËS

DIASPORA LIGHTS



Është më se e ditur se kontributi i Diasporës prek shumë dimensione të jetës në vendin tonë, sidomos atë ekonomik dhe shoqëror. Kjo, sepse Diaspora tashmë e disa vite ka qenë dhe po vazhdon të jetë një forcë e madhe për zhvillimin e vendit tonë.

Për të mirëpritur Diasporën dhe për të qenë edhe më falënderues për kontributin e tyre ndaj nesh, edhe Kosova në mënyrat e saj po përkujdeset që bashkatdhetarët tanë të kalojnë një kohë sa më të mirë në vendlindje.

Një kujdes të madh për Diasporën kanë treguar edhe kompani të shumta në vend, ndërsa pjesë e traditës këtë vit është bërë edhe KEDS dhe KESCO. Këto kompani kanë hapur platforma të veçanta bashkëpunimi për të përkrahur mërgatën.

Me qëllim dhe synim që të ofrohen shërbime të shpejta të energjisë elektrike për komunitetin e diasporës, KEDS dhe KESCO këtë verë kanë vendosur që kërkesat nga Diaspora për Lidhje të Reja me energji elektrike të trajtohen me prioritet të lartë.

Rudina Heroi-Puka, Drejtoreshë e Kujdesit për Konsumatorë, duke vlerësuar kontributin e Diasporës në zhvillimin ekonomik e sidomos në sektorin energjetik, ka shpalosur planet e kompanisë në mbështetje të Diasporës për këtë vit.

It is well known that the contribution of the Diaspora affects many dimensions of life in our country, especially the economic and social. This is because the Diaspora for several years has been and continues to be a great force for the development of our country.

In order to welcome the Diaspora and to be even more grateful for their contribution to us, Kosovo in its own way is taking care that our compatriots spend a better time in their homeland.

Many companies in the country have shown great care for the Diaspora, while KEDS and KESCO have also become part of the tradition this year. These companies have opened special cooperation platforms to support the diaspora.

In order to provide fast electricity services to the diaspora community, KEDS and KESCO this summer decided that the requests from the Diaspora for New Connections with electricity to be treated with high priority.

Rudina Heroi-Puka, Director of Customer Care, appreciating the contribution of the Diaspora in economic development, especially in the energy sector, has unveiled the company's plans in support of the Diaspora for this year.

Meqë kërkesat më të shpeshta të mërgatës janë kryesisht për energjizimin e shtëpive të reja që ata i ndërtojnë në Kosovë, KEDS dhe KESCO kanë punuar përkatësisht në përshpejtimin e kësaj kërke.

Kërkesat për Lidhje të Reja me energji elektrike bëhen në KEDS, si Operator i Sistemit të Shpërndarjes dhe mund të jenë të llojit shtëpiak apo komercial, varësisht për çfarë kapaciteti të energjisë ka nevojë konsumatori.

Në rastin e mërgatës, shumë nga lidhjet e reja janë konsumatorë shtëpiak, kërkesa këto që vijnë nga konsumatorë anekënd vendit, teksa të njëjtët janë të mërguar në shumë vende të botës.

“Së fundi, në bashkëpunim edhe me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, ne kemi përditësuar programet tona për të identifikuar kërkesat e tyre automatikisht, me qëllim të prioritizimit të tyre, “ka thënë Heroi-Puka.

Kjo nënkupton që kërkesat për lidhje të re me energji elektrike që bëhen nga Diaspora, gjatë kohës që ata janë në Kosovë, do të trajtohen me prioritet dhe kujdes të veçantë, në mënyrë që të shkurtohet koha e pritjes prej momentit kur bëhet kërkesa fizikisht në sportelet tona, e deri te vendosja e pikës matëse.

“Marrë parasysh faktin që sezoni i verës ndryshe njihet si “Muajt e Diasporës” dhe konsumatorët tanë nga diaspora kanë ditët e numëruara të qëndrimit në Kosovë, ne kemi dizajnuar procesin që pranimi dhe trajtimi i kërkesave të tyre të bëhet me prioritet,” tha ajo.

Since the most frequent requests of the diaspora are mainly for the energization of the new houses they build in Kosovo, KEDS and KESCO have worked respectively to accelerate this demand.

Requests for New Electricity Connections are made to KEDS as a Distribution System Operator and can be of domestic or commercial type, depending on what energy capacity the customer needs.

In the case of the diaspora, many of the new connections are domestic consumers, demands that come from consumers across the country, while the same are emigrated to many countries around the world.

"Finally, in cooperation with the Distribution System Operator, we have updated our programs to identify their requirements automatically, in order to prioritize them," said Heroi-Puka.

This means that requests for new electricity connections made by the Diaspora, while they are in Kosovo, will be treated with special priority and care, in order to shorten the waiting time from the moment when the request is made physically at our counters, until the placement of the measuring point.

"Considering the fact that the summer season is otherwise known as 'Diaspora Months' and our diaspora customers have numbered days of stay in Kosovo, we have designed the process to make accepting and handling their requests a priority," she said.

Rudina Heroi-Puka



Në mënyrë që Diaspora kosovare të vendoset si kategori e veçantë që prej momentit të aplikimit dhe deri në përfundim të procesit, KEDS dhe KESCO kanë krijuar edhe mekanizma identifikues.

Këto mekanizma përveç tjerash dokumente të zakonshme për të gjithë konsumatorët vendor, përbëjnë një dëshmi që vërteton se personi i cili aplikon jeton në diasporë.

Kjo po bëhet në mënyrë që ekzekutimi i kërkesave të mërgimtarëve të bëhen në kohën më të shkurtër të mundshme, marrë parasysh kohën e limituar që mërgimtarët kanë për ta shfrytëzuar në Kosovë.

In order for the Kosovar diaspora to be placed as a separate category from the moment of application until the end of the process, KEDS and KESCO have also established identification mechanisms.

These mechanisms, among other common documents for all domestic consumers, constitute a proof that the person who applies lives in the diaspora.

This is being done in order to execute the requests of the diaspora in the shortest possible time, taking into account the limited time that the diaspora have to spent in Kosovo.

Gjithsesi, një gjë e tillë nuk do të thotë që kërkesat e konsumatorëve të tjerë nuk do të merren me prioritet, pasi që KEDS ka shtuar numrin e ekipeve në terren, pikërisht për të zbatuar këtë shërbim sa më shpejt për të gjithë konsumatorët.

Meqë shumë bashkatdhetarë tanë kanë ardhur në Kosovë këtë verë, ata kanë dëgjuar për prioritetet e KEDS dhe ata të cilët kanë pasur nevojë kanë paraqitur kërkesa për Lidhje të Reja në KEDS.

Agron Pllana, i cili vjen nga një fshat i komunës së Prishtinës dhe jeton në Finlandë për 9 vjet, është shumë i kënaqur me realizmin e kërkesës për lidhje të re që e ka bërë në KEDS pak ditë pasi ka mbërritur në Kosovë. Ai u shpreh kështu:

“E kom ndërtu një shtëpi këtu para dy viteve. Këtë verë e kam rregullu. M’u ka dashtë ora e rrymës, edhe kom apliku në KEDS. Menjëherë jonë ardhë të nesërmen këtu edhe mbas tri katër dite erdhën me vendosë orën. Çdo gjë u shku mirë, dhe jam shumë i kënaqur. “

Ndërsa, për të lehtësuar marrjen e shërbimeve të energjisë elektrike dhe bashkëpunimin edhe nga distanca, KESCO në vitin 2018 ka lansuar aplikacionin eKesco.

Ky aplikacion ofron informata dhe zhvillime që lidhen me furnizimin me energji elektrike, ku konsumatorët mund t’i gjejnë të gjitha në një vend, pa pasur nevojë të bëjnë një hap jashtë shtëpisë.

However, this does not mean that the requests of other customers will not be given priority, as KEDS has increased the number of teams in the field, precisely to implement this service as soon as possible for all customers.


Since many of our compatriots have come to Kosovo this summer, they have heard about KEDS and those who had the need, have applied for New Connections at KEDS.

Agron Pllana, who comes from a village of the municipality of Prishtina, has been living in Finland for 9 years, is very satisfied with the realization of the request for a New Connection that he made to KEDS a few days after arriving in Kosovo. He said:

"I built a house two years ago. This summer I have prepared it for living. I needed a electricity meter, so I applied to KEDS. They immediately came the next day for inspection and after three or four days they installed the electricity meter. Everything went well, I am very pleased. "

While, to facilitate the reception of electricity services and cooperation also remotely, KESCO in 2018 has launched the e-Kesco application.

This application provides information and developments related to electricity supply, that consumers can find all in one place, without having to take a step outside the home.



Në tentativë për të përmirësuar shërbimet ndaj Diasporës, ky aplikacion është përditësuar vazhdimisht, varësisht prej kërkesave dhe nevojave që janë paraqitur.

Disa nga shërbimet e shumta që ky aplikacion ofron janë: Pagesa të energjisë elektrike, njoftime për punime në rrjet, bërja e kërkesave dhe ankesave e shumë shërbime të tjera.

“Një paketë e tillë e shërbimeve ju hyn në punë sidomos Diasporës kosovare, të cilët mund të hapin llogarinë e tyre nga kudo që ndodhen në botë dhe të marrin shërbime nga KESCO,” ka thënë Rudina, Drejtoreshë e Kujdesit për Konsumatorë në KESCO. Ajo ndër të tjera tha, se ndër 630 mijë konsumatorë sa ka KESCO, Diaspora janë shtyllë e rëndësishme dhe ne duhet të kujdesemi për ta.

Përmes aplikacionit eKesco mund të bëhen pagesa të energjisë elektrike nga cilido shtet i botës, rrjedhimisht kudo që Diaspora gjenden. Një sistem i tillë pranon pagesat me kartela Visa dhe Mastercard, ndërsa shërbimi është me 0 provizion.

Megjithatë, shërbimet që KEDS dhe KESCO ofrojnë për Diasporën nuk ndalen këtu. KESCO ofron edhe shërbimin e “Pagesave Direkte” për të gjithë konsumatorët të cilët preferojnë t’i kryejnë pagesat e tyre online, dhe në rast të Diasporës kjo është më se e favorshme.

In an attempt to improve services to the diaspora this application is constantly updated, depending on the requirements and needs that have arisen.

Some of the many services this application offers are: Electricity payments, announcements for network works, submission of requests and complaints and many other services.

"Such a package of services works especially well for the Kosovar Diaspora, who can open their account from anywhere in the world and receive services from KESCO", said Rudina, Director of Customer Care at KESCO. Among other things, she said that: "Among the 630 thousand customers that KESCO has, the Diaspora is an important pillar and we must take care of them".

Through the eKesco application, electricity payments can be made from any country in the world, consequently wherever the Diaspora is located. Such a system accepts payments with Visa and Mastercard cards, while the service is with 0 commission.

However, the services that KEDS and KESCO provide for the Diaspora do not stop here. KESCO also offers the "Direct Payments" service for all customers who prefer to make their payments online, and in the case of the Diaspora this is more than favorable.

Pagesat Direkte është platformë në ueb-faqen e KESCO, që mundëson pagesat e energjisë elektrike në vetëm 3 hapa, duke plotësuar të dhënat tuaja bazike.

Kjo njëherësh është mënyra më e thjeshtë elektronike për t'i paguar shpenzimet e energjisë elektrike, pasi që konsumatorët nuk kanë nevojë të hapin llogari apo të regjistrohen diku për të marrë një shërbim të tillë.

Direct Payments is a platform on the KESCO website, which enables electricity payments in just 3 steps, requiring your basic data.

This is also the simplest electronic way to pay for electricity, as consumers do not need to open an account or register somewhere to receive such a service.



**Edhe një punë
të fundit,
e pagova rrymën!**

Shkarko eKesco online:

FREE DOWNLOAD
App Store

FREE DOWNLOAD
Google Play

SI DHE KUR BËHET RIKYÇJA NË KESCO

HOW AND WHEN IS MADE THE RECONNECTION TO KESCO



KESCO ka për qëllim furnizimin e konsumatorëve me energji elektrike, si dhe gatishmërinë për të plotësuar kërkesat e tyre. Mirëpo, për një bashkëpunim sa më të mirë dhe të ndërsjellë, obligimet e kompanisë dhe konsumatorëve për njëra-tjetrën

duhet të respektohen përkitazi rregullave në fuqi, të aprovuara nga ZRRE - Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Në njërën nga këto rregulla, përkatësisht atë për shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve, thuhet që furnizimi me energji elektrike mund t'ju ndërpritet konsumatorëve të cilët nuk i përmbahen afatit të pagesës.

Pra, një shtëpi apo një objekt mund të shkyçet nga furnizimi me energji elektrike në rastet kur nuk plotësohen kushtet e nevojshme nga ana e konsumatorit për ta mbuluar pagesën e energjisë elektrike që konsumatori e ka shpenzuar sipas afatit të paracaktuar, shpenzim ky që figuron çdo muaj në llogarinë që konsumatori ka në KESCO. Gjithsesi, KESCO aplikon të gjitha mundësitë në

The purpose of KESCO is to supply customers with electricity, as well as the willingness to meet their requirements. But, like any other service and product, electricity must be paid and regarding the rules in force approved by ERO - Energy Regulatory Office (Rules for disconnection and reconnection of customers), electricity supply can be interrupted to customers who do not adhere to the payment deadline.

However, KESCO applies all possibilities in order to avoid disconnection of customers from the electricity network, notifying customers for disconnection, through the monthly invoices you receive from KESCO, as well as sending you notifications in the eKesco application. It is important to note that a customer can be disconnected even if he has paid the last invoice but has a pre-accumulated debt. If as an existing customer you are disconnected

mënyrë që të shmangë shkyçjen e konsumatorëve nga rrjeti elektrik, duke i paralajmëruar konsumatorët për shkyçje, përmes faturave mujore që i pranoni nga KESCO, si dhe duke ju dërguar njoftime në aplikacionin eKesco. Është e rëndësishme të theksohet se një konsumator mund të shkyçet edhe nëse ka paguar faturën e fundit, por ka borxh të akumuluar paraprak.

Nëse si konsumator ekzistues ju jeni shkyçur nga rrjeti elektrik për mos-pagesë, nga momenti kur keni kryer obligimet (borxhin) që keni ndaj KESCO-s, bazuar në rregullat në fuqi, objekti juaj do të rikyçet jo më vonë se 24 orë pasi të jenë plotësuar kushtet për rikyçje.

Si bëhet rikyçja e energjisë elektrike?

- Kushti i parë është të paguani borxhin që keni ndaj KESCO.
- Nëse për çfarëdo arsye objekti juaj nuk është rikyçur edhe pas 24 orëve, ju lutem na kontaktoni duke thirrur në Qendrën e Thirrjes në 0800 791 00, duke dërguar e-mail në info@kesco-energy.com apo duke vizituar sportelet tona në distriktin tuaj më të afërt.
- Po qe se kërkesën për rikyçje e bëni në sportel, me vete ju duhet ta keni edhe dëshminë që keni paguar borxhin tuaj në KESCO.
- KESCO e adreson kërkesën te ekipet teknike të KEDS si operator i shpërndarjes, dhe pastaj merret me shqyrtimin e saj.
- Nëse konstatohet që objekti në fjalë i plotëson kushtet për t'u rikyçur, që nënkupton se borxhi i paraparë është paguar nga ana juaj, furnizimi me energji elektrike do të rikthehet sa më parë.

A marr njoftim paralajmërues për shkyçje?

Bazuar në rregulloren në fuqi mbi Shkyçjen dhe Rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë, konkretisht mbi njoftimin paralajmërues për shkyçje, thuhet:
“Përpara shkyçjes konsumatorit do t'i dërgohet

from the electricity network for non-payment, from the moment you have fulfilled your financial obligations to KESCO, based on the rules in force, your facility will be reconnected no later than 24 hours after the conditions for reconnection have been met.

How is electricity reconnected?

- *The first condition is to pay your debt to KESCO.*
- *If for any reason your facility is not reconnected even after 24 hours, please contact us by calling the Call Center at 0800 791 00, sending an e-mail to info@kesco-energy.com or visiting our counters in your nearest district.*
- *If you make the request for reconnection at the counter, you must have with you the proof that*

you have paid your debt to KESCO.

- *KESCO addresses the request to KEDS technical teams as the distribution operator, which then handles its review.*
- *If it is found that the facility in question meets the conditions to be reconnected, which means that the foreseen debt has been paid by you, the electricity supply will be restored as soon as possible.*

Do I receive a disconnection warning notice?

Based on the regulation in force on Disconnection and Reconnection of consumers in the energy sector, specifically on the warning notice for disconnection, it is stated:

"Before disconnection, the consumer will be sent a warning notice on the invoice regarding the unpaid debt. The period of the warning notice shall not be less than fifteen (15) calendar days from the last date of the payment deadline. "

The notice of disconnection to be sent to the customer shall contain the measures to be taken against the customer, including disconnection in case he does not perform the actions specified in the notice of disconnection within the specified time limit.

Please note, if you are an active user of the eKesco app, you can also receive

njoftimi paralajmërues në faturë lidhur me borxhin e papaguar. Periudha kohore e njoftimit paralajmërues nuk mund të jetë më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e fundit e afatit të pagesës.” Njoftimi paralajmërues për shkyçje që do t’i dërgohet konsumatorit, do të përmbajë masat që do të ndërmerren ndaj konsumatorit, përfshirë edhe shkyçjen në rast se ai nuk kryen veprimet e specifikuara në njoftimin paralajmërues brenda afatit të përcaktuar kohor.

Vini re, nëse jeni përdorues aktiv i aplikacionit eKesco, ju mund t’i merrni njoftimet paralajmëruese për shkyçje edhe nëpërmjet këtij aplikacioni.

Unë kam paguar faturën e fundit, pse jam shkyçur?

Sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi çdo konsumator mund të shkyçet nëse ka fatura të papaguara të mëparshme (borxh paraprak), edhe në qoftë se ju keni paguar faturën e fundit.

Ku mund ta bëj pagesën e energjisë elektrike?

Konsumatorët kanë në dispozicion shumë kanale për të kryer pagesat e energjisë elektrike. Pagesat e energjisë elektrike mund të bëhen në arka të KESCO-s, në aplikacionin mobil eKesco, Pagesa Direkte nëpërmjet ueb-faqes së KESCO-s, bankave komerciale (sporteleve dhe e-banking), institucioneve financiare jo-bankare dhe përmes Postës së Kosovës.

Gjatë bërjes së pagesës është e rëndësishme që konsumatori të ketë kujdes dhe ta shkruajë saktë shifrën e tij/saj të konsumatorit, në mënyrë që mos të ndodhë ndonjë ngatërresë në pagesë.

disconnection notifications through this app. I paid the last invoice, why was I disconnected?



According to the rules and laws in force any customer can be disconnected if there are previously unpaid bills (previous debt), even if you have paid the last bill.

Where can I pay for electricity?

Customers have many channels available to make electricity payments.

Electricity payments can be made at KESCO cashier counters, in the eKesco mobile application, direct payments through the KESCO website, commercial banks (counters and e-banking), non-bank financial institutions and through the Post of Kosovo.

When making a payment, it is important for the customer to be careful and write his / her customer ID correctly, so that there is no confusion in the payment.



ARRIVALS

**Derisa të vijnë
me më marr,
po e bëj pagesën
e rrymës**



Pagesa direkte
www.kesco-energy.com

KEDS TRAJTOI ME PRIORITET KËRKESAT E DIASPORËS PËR LIDHJE TË REJA GJATË VERËS

KEDS PRIORITIZED DIASPORA REQUESTS FOR NEW CONNECTIONS DURING THE SUMMER

Sivjet stina e verës filloi me lajme të mira për Diasporën. Kjo, pasi KEDS kishte vendosur që kërkesat e mërgimtarëve nga diaspora për energjizim të objekteve të banimit t'i trajtojë me prioritet.

Që nga ardhjet e grupeve të para të bashkatdhetarëve në vendlindje, KEDS u mobilizua për qenë në shërbim të tyre.

Në këtë drejtim, KEDS përmes një sistemi të identifikimit të kërkesave për Lidhje të Reja për pjesëtarët e Diasporës, mundësonte që kërkesat e mërgimtarëve të vihen në prioritet.

Që nga fillimi i kësaj fushate ishte vërejtur një numër i madh i aplikimeve.

Me qëllim që t'u mundësohej realizimi i të gjitha kërkesave në kohën më të shpejtë të mundshme, KEDS kishte angazhuar ekipe shtesë në terren, duke dyfishuar kapacitetet.

Për të përfituar nga shërbimi i trajtimit me prioritet të kërkesës, konsumatorët që vinin nga Diaspora u kërkohej të kenë me vete dokument identifikimi nga vendi që vijnë për të paraqitur pastaj kërkesën

This year the summer season started with good news for the Diaspora. This is because KEDS had decided to prioritize the requests of compatriots from the diaspora for energization of residential buildings.

Since the arrival of the first groups of compatriots in the homeland, KEDS has been mobilized to be at their service.

In this regard, KEDS, through a system for identifying requests for New Connections for members of the Diaspora, enabled the requests of compatriots to be prioritized.

From the beginning of this campaign a great interest of applications was noticed.

In order to enable the realization of all requests in the fastest possible time, KEDS had engaged additional teams in the field, doubling the capacity.

To benefit from the priority request handling service, customers coming from the diaspora were required to bring with them an identification document from the country they come to then submit the request at the KEDS counters.



Lidhjet e Reja për Diasporën

në sportelet e KEDS. Më pas kompania shqyrtonte kërkesën në kohën më të shkurtër të mundshme dhe e njëjta procedohej tutje.

Konsumatorët nga Diaspora e pritën mjaft mirë një iniciativë të tillë derisa thanë se nuk kanë menduar që kërkesat e tyre do të trajtoheshin në një afat kaq të shpejtë.

“Jam befasuar, kam menduar që ka me shku shumë më gjatë, por shumë mirë...Me thënë të drejtën ne jemi shumë falënderues KEDS-it që na e ka realizuar kërkesën brenda katër ditëve, se ne jemi mërgimtarë edhe i kemi ditët e caktuara, nuk jemi kohë të gjatë këtu edhe u krye puna shumë mirë”, tha Burhan Maloku, i cili jeton në Zvicër, ndërsa në Kosovë ka ndërtuar shtëpinë në komunën e Shtimes.

Njëjtë sikurse ai, edhe Florim Statovci, i cili jeton në Finlandë, kurse shtëpinë e ka ndërtuar në Lipjan, tha se është befasuar për të mirë kur ka kuptuar që kërkesa e tij u realizua kaq shpejt.

“Kërkesën e kemi bërë ditën e hënë, kanë ardhur tash, nuk e kemi besuar as vet, kështu që jemi shumë të kënaqur për këtë punë...Ne kohën e

The company then reviewed the request in the shortest possible time and further processed.

Consumers from the Diaspora welcomed such an initiative quite well while they said that they did not think that their requests would be addressed in such a short time.

"I was surprised, I thought it would take much longer, but it was very fast... To be honest we are very grateful to KEDS for fulfilling our request within four days, since we are compatriots and we have counted days. We are not here for a long time and the work was done very well", said Burhan Maloku, who lives in Switzerland, while in Kosovo he built a house in the municipality of Shtime.

Same as him, Florim Statovci, who lives in Finland and built his house in Lipjan, said he was surprised to learn that his request was addressed so quickly.

"We made the request on Monday, they came now, we did not even believe it, so we are very satisfied with such work... We have very limited time here on vacation, so we have very little time, they came now, and for us this is very good.



KEDS ka ndërtuar një sistem të identifikimit të kërkesave për Lidhje të Re për Diasporën

kemi shumë të limituar këtu në pushim, kështu që kohë kemi shumë pak, po kanë ardhur tash që për neve kjo është shumë e mirë. Më kanë kërkuar një dokument që jam jashtë si mërgimtar, i kam dhënë dhe më është thënë që procedura ka me u shpejtua dhe sot kanë ardhur, jemi shumë të kënaqur”, tha ai.

KEDS mbetet kompani e përkushtuar që të jetë sa më afër konsumatorëve. Ndërtimi i partneritetit me konsumatorë dhe ofrimi i shërbimeve sa më kualitative janë prioritetet e kompanisë

They asked me for a document that I live abroad as an compatriot, I gave it to them and I was told that the procedure should be speeded up and today they came, we are very satisfied", he said.

KEDS remains a company committed to being as close as possible to its customers. Building partnerships with customers and providing the highest quality services are the company's priorities.





Kurrë s'e kisha ditë
që përmes ueb-faqes
së KESCO-s muj me
pagu. Kjo pagesa
direkte ish pshtim

Pagesa direkte
www.kesco-energy.com


TETË ME NJË- GONETA DHE ARDITI

Të dy kanë profilin e inxhinierisë elektrike dhe studentë të KEDS Academy. Goneta vjen nga gjenerata e parë e KEDS Academy, kurse Ardit nga e teta.

Both have the profile of electrical engineering and KEDS Academy students. Goneta comes from the first generation of KEDS Academy, while Ardit from the eighth.



Goneta Peçani,
Inxhinieri në KEDS



Koincidenca është se të dyve ju pëlqen të punojnë në Departamentin e Investimeve. Në këtë rast Goneta është një udhërrëfyese për Arditin.

Me një përvojë 7-vjeçare Goneta është një inxhinieri e suksesshme dhe aktualisht punon në Departamentin e Investimeve, në pozitën inxhinieri e Planifikimit të Projekteve. Kurse Ardit së fundmi ka përfunduar pjesën praktike dhe në shtator do të nisë fazën e inernshipit.

Goneta me entuziazëm rrëfen fillimet kur i gjithë grupi në fakultet patën aplikuar për KEDS Academy në vitin 2013 dhe e shihnin si një

Coincidentally, they both enjoy working in the Investment Department. In this case Goneta is a guide for Ardit.

With 7 years of experience, Goneta is a successful engineer and currently works in the Investment Department, in the position of Project Planning Engineer. Whereas Ardit has recently completed the practical part and in September will start the internship phase.

Goneta enthusiastically recounts the beginnings when the entire faculty group applied to KEDS Academy in 2013 and saw it as a golden

EIGHT WITH ONE - GONETA AND ARDIT

“ KEDS ju jep shumë hapësirë inxhinierëve të rinj, duke u përkrahur dhe ndihmuar nga stafi me përvojë. Por këtu zhvillohen edhe aktivitete të shumta të Përgjegjësisë Shoqërore dhe respektohen të drejtat gjinore.”

“KEDS gives a lot of space to young engineers, being supported and assisted by experienced staff. Many activities of Social Responsibility are also held and gender rights are respected”.

Goneta Peçani, KEDS Engineer

mundësi të artë. Ajo ndjehet me fat që u pranua dhe ka fjalë të mëdha për gjithë projektin, duke veçuar pjesën e ligjëratave dhe stafin ligjërues. (Sidomos profesor Ruhi Kaykayoglyn e ka gjithmonë në kujtesë). Goneta ka kaluar nëpër disa departamente të KEDS, kurse tani është pjesë e Departamentit të Investimeve. “Çdo departament të KEDS mund ta quaj një puzzle për të plotësuar kompaninë. Punën e kam filluar në Departamentin e Masterplanit. Është vendi ku njoftohesh me të gjithë rrjetin elektrik, me databazën, skemat e pajisjet elektrike. Aty mëson se si ta identifikosh problemin dhe zgjidhjen e tij. Pa harruar të përmendi ndihmën dhe mikpritjen e stafit të KEDS, të cilët gjithmonë janë aty kur është nevoja”, shprehet ajo. Kurse për Arditi inxhinieria është një profesion sfidues dhe me perspektivë.

“Më ka pëlqyer shumë matematika, por inxhinierinë e shoh si profesion ku mund të sfidosh veten. Dhe sa po shoh, nuk ka vend më adekuat se në KEDS për të gjetur veten si inxhinier i elektronikës dhe një perspektivë për të ardhmen time”, ka thënë ai.

Goneta tregon se KEDS nuk merret vetëm me punët e rrjetit elektrik, por edhe me shumë aktivitete për shoqërinë dhe mjedisin ku jetojmë. “ Këtu punohet shumë dhe një fakt që duhet të cek, është se KEDS ju jep shumë hapësirë inxhinierëve të rinj , duke u përkrahur dhe ndihmuar nga stafi me përvojë. Por këtu zhvillohen

opportunity. She feels lucky to have been accepted and has big words for the whole project, highlighting the part of the lectures and the teaching staff. (Especially Professor Ruhi Kaykayoglyn is always remembered). Goneta has gone through several KEDS departments, and is now part of the Investment Department. "Every KEDS department can be called a puzzle to complete the company. I started working in the Master Plan Department. It is the place where you get acquainted with the entire electrical network, with the database, schemes and electrical equipment. There you learn how to identify the problem and its solution. Without forgetting to mention the help and hospitality of the KEDS staff, who are always there when needed", she says. For Ardit, engineering is a challenging and promising profession.

"I liked maths a lot, but I see engineering as a profession where you can challenge yourself. As far as I can see, there is no more adequate place than in KEDS to find myself as an electronics engineer and a perspective for my future," he said.

Goneta points out that KEDS does not only deal with the work of the electricity network, but also with many activities for the society and the environment where we live.

"A lot of work is done here and a fact that should be mentioned, is that KEDS gives a lot of space to young engineers, being supported and assisted

edhe aktivitete të shumta të Përgjegjësisë Shoqërore dhe respektohen të drejtat gjinore”, ka thënë Goneta.

Edhe pse për dy gjeneratat e fundit mësimi është mbajtur online, për Arditin gjithçka ka qenë si duhet. Por pjesa e praktikës për të ka qenë ajo që ka plotësuar mësimet teorike, që në fakultet i kanë pasur të mangëta.

“Përveç prezencës fizike, asnjë mungesë tjetër nuk kemi ndjerë. Profesorët kanë qenë shumë të përgatitur dhe gjithçka ka qenë mirë. Puna në grupe më ka pëlqyer shumë dhe na ka bërë më kreativë duke na mundësuar që të shoqërohemi e të njohim më shumë njëri-tjetrin”, përfundon Ardit. KEDS Academy është një tregim suksesi që ndihmon të rinjtë në Kosovë në edukimin, zhvillimin dhe i përgatit ata për tregun e punës.

by experienced staff. Many activities of Social Responsibility are also held and gender rights are respected”, said Goneta.

Although for the last two generations the lessons have been held online, for Ardit everything has been as it should be. For him, the practical part was the one that complemented the theoretical lessons that he had lacked in the faculty.

“Apart from the physical presence, we have not felt any other absence. The professors have been very prepared and everything has been fine. I liked working in groups very much and it made us more creative, enabling us to socialize and get to know each other better,” Ardit concludes.

KEDS Academy is a success story that helps young people in Kosovo in education, development and prepares them for the job labor market.

Ardit Dragusha, student i vitit të parë të KEDS Academy



“Nuk ka vend më adekuat se në KEDS për të gjetur veten si inxhinier i elektronikës dhe një perspektivë për të ardhmen time.”



“There is no more adequate place than in KEDS to find myself as an electronics engineer and a perspective for my future.”

Ardit Dragusha, a first year student at KEDS Academy



Nani,

a u mësove me përdorë
eKesco-n a? Supeeeeer!

Shkarko *eKesco* online:



FREE DOWNLOAD
App Store



FREE DOWNLOAD
Google Play

NGJARJET QË KARAKTERIZUAN KEDS DHE KESCO

**KEDS bashkëpunim
të frytshëm me të
gjithë komunat e
vendit, në dobi
të qytetarëve**

KEDS ka vazhduar takimet me komunat në të gjithë Kosovën, diku për të diskutuar për nevojat, planifikimet dhe investimet për atë komunë dhe po ashtu në disa komuna për të vizituar investimet që janë në implementim e sipër. Bashkëpunimi me komunat është i rëndësishëm për KEDS dhe bëhet për të qenë sa më afër çdo konsumatori në çdo vendbanim të Kosovës.



KEDS fruitful cooperation with all municipalities, for the benefit of the citizens

KEDS has continued meetings with municipalities throughout Kosovo, somewhere to discuss the needs, planning and investments for that municipality and also in some municipalities to visit the investments that are being implemented. Cooperation with municipalities is important for KEDS and is done to be as close as possible to every customer all over Kosovo.

EVENTS THAT CATEGORIZED KEDS AND KESCO



Kërkesat e bashkatdhetarëve për energjizimin e objekteve - prioritet i KEDS-it për këtë verë

Këtë verë KEDS ka ndërmarrë fushatën për prioritetizimin e kërkesave për lidhje të reja për konsumatorët të cilët jetojnë në diasporë. Kjo është bërë me qëllimin që konsumatorëve të diasporës t'u lehtësohet qëndrimi këtu dhe mbi të gjitha t'u energjizohen shtëpitë e tyre gjatë qëndrimit në vendlindje. Kërkesat kanë qenë të shumta dhe po ashtu edhe implementimi është bërë në afatin më të shkurtër të mundshme. Për të qenë të suksesshëm në këtë shërbim KEDS ka dyfishuar numrin e punëtorëve. Kjo ka mundësuar që edhe kërkesat tjera të implementohen brenda afatit ligjor.



KESCO me fushatë për benefitet e përdorimit të aplikacionit eKesco dhe pagesave direkte për konsumatorët, me theks të veçantë për ata të diasporës

Gjatë kësaj vere KEDS ka organizuar fushatën për të informuar konsumatorët me mundësitë më të lehta për qasje në shërbime dhe pagesa të energjisë elektrike. Kjo fushatë është organizuar me theks të veçantë për diasporën në mënyrë që të lehtësojë qëndrimin e tyre këtu e po ashtu t'ju mundësojë qasje në njëhisorin e tyre edhe pas kthimit në vendet ku ata jetojnë. Po ashtu janë përgatitur edhe fletushka informative që janë vendosur në të gjitha arkat dhe zyrat e shërbimeve për konsumatorë, duke filluar nga pyetjet më të shpeshta që pranojmë, hapat e regjistrimit në aplikacionin eKesco dhe deri te hapat në përpikëri se si ta realizojmë një kërkesë.

Compatriots' requests for energization of facilities - KEDS priority for this summer

This summer KEDS has launched a campaign to prioritize requests for new connections for consumers living in the diaspora. This is done in order to make it easier for diaspora consumers while they are in Kosovo and, above all, to energize their homes while staying in their homeland. The requests have been numerous and also the implementation has been done in the shortest possible time. To be successful in this service KEDS has doubled the number of employees. This has enabled other requirements to be implemented within the legal deadline.

KESCO with campaign for the benefits of using the eKesco application and direct payments to consumers, with special emphasis on those in the diaspora

During this summer KEDS has organized a campaign to inform consumers with the easiest opportunities for access to services and payment of electricity. This campaign is organized with a special emphasis on the diaspora in order to facilitate their stay here and also to give you access to their meter even after returning to the places where they live. Informative leaflets have also been prepared and placed in all cash registers and customer service offices, starting with the most frequently asked questions we receive, the registration steps in the e-Kesco application and up to the exact steps on how to complete a request.





Trafot e rrymës po shndërrohen në objekte artistike në Drenas

Pas bashkëpunimit të frytshëm me Komunën e Prishtinës për ngjyrosjen e trafave nga artistë të vendit e ndërkombëtar, KEDS ka bashkëpunuar edhe me Komunën e Drenasit. Qëllimi i këtij bashkëpunimi është që trafostacionet e KEDS të shndërrohen në objekte urbane, duke iu dhënë gjallëri lagjeve ku ato janë të vendosura dhe njëkohësisht të mundësohet promovimi i artit dhe artistëve të rinj.

KEDS, duke qenë pjesë e këtyre projekteve, shpreh vendosmërinë dhe gatishmërinë që të luajë rol të madh edhe në aktivitetet e Përgjegjësisë Shoqërore të Korporatës, që ndikojnë direkt në kualitetin e jetës së komunitetit.

Electricity transformers are being turned into artistic objects in Drenas

After fruitful cooperation with the Municipality of Prishtina for painting the transformers by local and international artists, KEDS has also cooperated with the Municipality of Drenas. The purpose of this cooperation is to turn KEDS substations into urban objects, giving life to the neighborhoods where they are located and at the same time to enable the promotion of art and young artists. KEDS, being part of these projects, expresses its determination and readiness to play a major role in the activities of Corporate Social Responsibility, which directly affect the quality of life of the community.



KEDS pjesë e panelit të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë

KEDS ishte pjesë e panelit të organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë për të folur për ndikimin e pandemisë në aktivitetet e Përgjegjësisë Shoqërore të Kompanisë (CSR). Ndër të tjera u përmendën disa nga projektet madhore të KEDS në kuadër të CSR, siç janë KEDS Academy, Art n'trafo, Principet e UN Women - WEPs, trajnimet për Barazi Gjinore, si dhe mënyrën e realizimit të këtyre projekteve në mes të vështirësive që solli pandemia.

KEDS part of the panel of the American Chamber of Commerce in Kosovo

KEDS was part of a panel organized by the American Chamber of Commerce in Kosovo to talk about the impact of the pandemic on the Company's Social Responsibility (CSR) activities. Among others were mentioned some of the major projects of KEDS within the CSR, such as KEDS Academy, Art n'trafo, Principles of UN Women - WEPs, trainings on Gender Equality, as well as how to implement these projects amidst the difficulties that pandemic brought.





KEDS nënshkroi Memorandum Mirëkuptimi me Federatën e Futbollit të Kosovës

.....
Drejtori i Divizionit të Rrjetit në KEDS, Alpin Dogan, dhe presidenti i Federatës të Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, kanë vënë firmat për një Memorandum Mirëkuptimi. Ky Memorandum do të krijojë kushte për bashkëpunim të ndërsjellë mes KEDS dhe FFK me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore me energji elektrike në të ardhmen për stadiumin e Prishtinës "Fadil Vokrri". KEDS gjithashtu do të ofrojë edhe të gjithë materialin elektrik të nevojshëm për implementimin e projektit në Kampin Nacional "Hajvalia". FFK ka falënderuar KEDS-in për këtë mbështetje. Këto shërbime të KEDS do të ndikojnë në zhvillimin e sportit në Kosovë.

KEDS signed a Memorandum of Understanding with the Football Federation of Kosovo

The Director of the KEDS Network Division, Alpin Dogan, and the President of the Kosovo Football Federation, Agim Ademi, have signed a Memorandum of Understanding. This Memorandum will create conditions for mutual cooperation between KEDS and KFF in order to provide quality services with electricity in the future for the stadium of Prishtina "Fadil Vokrri". KEDS will also provide all the necessary electrical material for the implementation of the project in the National Camp "Hajvalia". KFF thanked KEDS for this support. These KEDS services will affect the development of sports in Kosovo.

KESCO vazhdon të mbështesë aktivitetet dhe kauzat e Klubit Alpin Prishtina



.....

“Tani i kam 40 vjet përvojë pune në këtë kompani, që fillimisht ka qenë kompani shtetërore, ndërsa para 8 viteve është privatizuar dhe sot e njohim si KEDS. Gjatë këtyre viteve kam punuar në disa departamente dhe në të njëjtat kam pasur punë në terren dhe zyrë.”

Gjatë karrierës së saj, Teuta ka qenë projekt-menaxhere e disa projekteve madhore të shtrira nëpër tërë Kosovën. Disa nga këto projekte kanë qenë edhe donacione nga shtetet e jashtme për Kosovën. Njëri ndër këto projekte që Teuta e veçon, është projekti që e ka udhëhequr menjëherë pas luftës: “Donacioni i parë dhe më i madhi që pas luftës (vlëra 32,000,000 marka) ka qenë gjatë periudhës nëntor 1999-qershor 2000, nga Qeveria Angleze, DFID. Kohëzgjatja e

Engineering at the University of Prishtina, Department of Energetics. This article features excerpts from the interview with Teuta where we talked about her life and career, focusing on her profession and experience as an energy engineer, now close to retirement. iAt first we asked Teuta why she chose the profession of engineering and as she talked with great passion, she told us:

"My choice of profession has been influenced by my love and inclination for scientific subjects such as: mathematics, physics, chemistry, etc. Since elementary school I loved these subjects, so this has been the basis for selecting my profession."

The Faculty of Energy then had a 5-year system and most of the literature with which students studied was in Serbo-Croatian. Also, at the time Teuta enrolled in the university, the engineering profession was considered a male profession. But despite all of this, Teuta was determined to achieve success in her journey as an energetics engineer. She started her career as an engineer in Elektrokosovo in 1982 in Gjilan, a year after graduating from the technical faculty, and since then, 40 years of fruitful experience have passed for Teuta.

“Now I have 40 years of work experience in this company, which was initially a public company, while 8 years ago it was privatized and today we know it as KEDS. During these years I have worked in several departments and done both, field and office work. “

During her career, Teuta has been the project manager of several major projects throughout Kosovo. Some of these projects have been donations from foreign countries to Kosovo. One of these projects that Teuta singles out is the project she led immediately after the war: “The first and largest donation after the war (32,000,000 German marks of value) was during the period November 1999-June 2000, by the British Government, DFID. The time duration implementation of this project was only 6 months and covered the entire territory of Kosovo.”

implementimit të këtij projektit ka qenë vetëm 6 muaj dhe ka përfshirë tërë territorin e Kosovës." Për përvojën e saj në KEDS gjatë këtyre 8 viteve, Teuta shprehet:

"Për këto 8 vjet sa kam qenë pjesë e KEDS, është punuar shumë në zgjerimin e rrjetit. Kurrë, qe gjithë këto vite që punoj, nuk është punuar ma shumë, nuk është investuar ma shumë në Kosovë se sa gjatë kohës sa kam qenë në KEDS. Këtu çdo vit kemi pas mesatarisht 20 milionë euro investime në rrjet."

Sipas Teutës investimet bëhen për ta përmirësuar furnizimin, njëkohësisht edhe jetën, pra për të pasur shërbime më cilësore të energjisë elektrike dhe shpërndarje më optimale.

Znj. Buçinca shtoi se rrjeti energjetik i trashëguar nuk ka qenë në gjendje aspak të mirë dhe investimet e KEDS ndër vite ishin më se të qëlluara.

"Vlen të ceket që rrjeti elektro-energjetik ka qenë shumë i shkatërruar nga lufta po edhe gjatë 10 viteve sa kemi qenë të udhëhequr nga pushteti serb. Nuk është investuar fare dhe kjo ka shkaktuar çrregullime dhe pamundësinë e furnizimit të konsumatorëve me energji elektrike, si nga cilësia po ashtu edhe nga sasia."


Regarding Teuta's experience at KEDS during these 8 years, she says:

"For these 8 years that I have been part of KEDS, a lot of work has been done to expand the grid. For all these years I have been working, never have I seen so much work done in a company, nor was invested this much that is being invested at KEDS. Here, we have had an average of 20 million euros in grid investments every year. "

According to Teuta, investments are made to improve the electricity supply, at the same time life, to provide better quality of electricity and more optimal distribution.

Mrs. Buçinca added that the inherited energy network has not been in good condition before KEDS and the investments done over the years have been very welcomed.

"It is worth mentioning that the electricity network has been destroyed by the war, especially during the 10 years as we were under Serbian government. It has not been invested at all and this has caused breakdowns and the unavailability to supply customers with electricity both in terms of quality and quantity. "



Duke folur për rezultatet e suksesshme të investimeve të KEDS ajo thekson:

“Me projektet investive të realizuara deri më tani, kemi arritur të zëvendësojmë shtyllat e vjetra të drurit me shtylla të betonit, janë bërë unazat – për furnizim alternativ që dmth, se nëse ndodhin avari, janë krijuar mundësitë që konsumatorët të mos mbesin pa energji elektrike.”

Kjo punë e madhe e kryer nga KEDS, ka hapur rrugët për zgjerimin e stafit. Kjo është mundësuar edhe nga programi KEDS Academy, që brenda një periudhe njëvjeçare sa zgjat programi, ka për qëllim t'i trajnojë dhe aftësojë studentët kosovarë për tregun e punës.

Gjatë bisedës Teuta na mahniti me dashurinë dhe përkushtimin që ushqen për profesionin e saj prej inxhinierje.

Speaking about the successful results of KEDS investments, she emphasizes:

"With the investment projects realized so far, we have managed to replace the old wood poles with concrete poles, rings have been created - for alternative supply, which means that if breakdowns occur, opportunities have been created so that consumers are not left without electricity. "

This great work done by KEDS, has paved the way for staff expansion. This is also made possible by the KEDS Academy program, which within a one-year period of the program, aims to train and prepare Kosovar students for the labor market. During the conversation Teuta amazed us with the love and dedication she nurtures for her profession as an engineer:

"Kurrë nuk kam mundur ta shfrytëzoj më shumë se 5 ditë pushimin, sepse natyra e punës ka qenë e tillë. Realizimi i projekteve ka qenë gjithmonë sfidues dhe ka kërkuar angazhim të vazhdueshëm."

"I have never been able to use more than 5 days of my annual leave because of the nature of work. The completion of projects has always been challenging and has required constant commitment."

Natyrisht që aty ku bëhet punë, përveç zhvillimit profesional ka edhe sfida me të cilat ajo është ballafaquar gjatë karrierës së saj. Sipas Teutës, gjërat do të ishin pak më të lehta nëse ligji do të vepronte siç duhet në Kosovë.

Of course in addition to professional development, there are challenges that she has faced during her career. According to Teuta, things would be a little easier if law would fully operate in Kosovo.

“Kjo punë është shumë kreative edhe pse ka sfida të mëdha, sepse kompletimi i secilit projekt është një e re që sjell shumë përfitime për popullin. Edhe terreni në vete është sfidë, sepse ke punë me njerëz të ndryshëm. Meqë kjo punë varet prej shumë faktorëve, ti duhet të jesh urë, me ditë me u marr vesh me të gjithë.”

"This work is very creative even though there are great challenges, because the completion of each project brings many benefits to the people. The terrain itself is also a challenge, because you work with different people. Since this work depends on many factors, you have to be a bridge, to know how to find a common ground with everyone."

Si njëra ndër gratë e rralla inxhinierë në vend, përveç punës nga zyra, Teuta ka mbikëqyrur punimet në terren, që ndonjëherë nuk kanë qenë edhe lehtë të menaxhohet, por me punën e saj të pandalshme dhe komunikimin efikas, suksesi nuk ka munguar. Sipas Teutës, gjithsecili nga ne duhet me qenë më komunikues dhe më i hapur për të mësuar gjëra të reja në ambiente pune.

As one of the few women engineers in the country, in addition to office work, Teuta has overseen fieldwork, which has sometimes not been easy to manage, but with her relentless commitment and efficient communication - success was always present.

According to Teuta, each of us should be more communicative and more open to learn new things in the work environment.



Tejkalimi i sfidave të punës natyrisht që është bërë më i lehtë me ndihmën e kolegëve bashkëpunues në zyrë dhe jashtë saj. E Teutës padyshim që do t'i mungojë tempoja e punës me të cilën është mësuar tash e gati 40 vite si dhe koha që e kalon me kolegë.

"Ndoshta kam me pas pak vështirë se jam mësuar me këtë punë. Ka me më mungu komunikimi me kolegë, ndonjëherë kemi qeshur, kemi folur, kemi pas pengesa, probleme e vështirësi që kërkonin zgjidhje, po duke ndërtuar marrëdhënie të mira mes veti, ia dilnim."

Ndërsa, kur e pyetëm se si e kalon kohën e lirë, Teuta na tregoi që e ka pasion leximin si dhe ecjen. Ajo foli edhe për librin të cilin ishte duke e lexuar këto ditë, i titulluar "Dhoma e Fluturave" nga autorja irlandeze Lucinda Riley. Një tjetër autore nga e cila Teuta ka lexuar shumë libra së fundi është edhe autorja turke Elif Shafak. Në fund e pyetëm Teutën nëse ka ndonjë mesazh për gratë inxhinierë. Ajo na dha mesazhin për të dy gjinitë.

"Mesazhi im është që duhet me u mundu, me punu me tanë energjinë e me tanë qenien. Punën të cilën e bëni duhet ta doni dhe t'i përkushtoheni, kështu do të arrini t'i tejkaloni të gjitha peripecitë me të cilat do të ballafaqoheni gjatë punës dhe kjo njëkohësisht do t'ju sjellë suksesin, qëllimin, në realizimin e punëve dhe detyrave tuaja."


Overcoming work challenges has of course been easier with the help of collaborative colleagues in and out of the office.

Teuta will definitely miss the pace of work with which she has been accustomed for almost 40 years and the time she spends with colleagues.

"Maybe it will be a bit difficult for me to get used without the work I do daily. I will miss communication with colleagues, sometimes we laughed, we talked, we had problems and difficulties that required solutions, but by building good relations between us, we succeeded."

Whereas, when we asked her how she spends her free time, Teuta told us that she has a passion for reading and walking. She also talked about the book she was reading these days, entitled "The Butterfly Room" by Irish author Lucinda Riley. Another author from whom Teuta has read many books recently is the Turkish author Elif Shafak. In the end we asked Teuta if she has any message for women engineers. She gave us a message for both genders.

"My message is that we have to work hard, to work with all of our energy and with our entire being. You have to love and dedicate yourself to the work you do, so you will be able to overcome all the challenges you face during the work and this will at the same time, bring you success in the completion of your objectives and your duties."



Tash s'po mërzitna
a kom me i gjet
faturat te dera,
se krejt muj me i
pa dhe me i shkarku
në eKesco

Shkarko eKesco online:



FREE DOWNLOAD
App Store



FREE DOWNLOAD
Google Play



PANDEMIA E VETONIT NË TRI AKTE

VETON PANDEMIC IN THREE ACTS



Nga roli aktiv në ndërmarrjen e masave preventive para pandemisë dhe puna e vazhdueshme gjatë pandemisë, ditët e kaluara në spital gjatë ballafaqimit me Covid 19 dhe periudha pas tij. Vetton Pehlivani, Menaxher Operativ në KEDS tregon rrugëtimin 18-mujor në tri akte.

Të gjithë kanë rrëfimin e tyre për pandeminë Covid 19, edhe Vetton Pehlivani, Menaxher në Divizionin e Operimit në KEDS ka të tijën.

Ai tregon hyrjen në periudhën e vështirë gjatë fillimit të vitit të kaluar nga një virus i panjohur që po godiste krejt globin.

"Përderisa pandemia po ofrohej, brengosësja shumë për familjen. Por, brengë e madhe ishte edhe fakti që punëtorët që kam nën menaxhim duhet të dilnin në terren. Në ato situata, kur e gjithë bota ishte konfuze dhe nuk dinin si të vepronin, brengat vetëm rriteshin. Çka do të ndodhë, si të veprojmë më së miri për punëtorët tanë", kujton atë periudhë Vettoni.

From the active role in undertaking preventive measures before the pandemic and the continuous work during the pandemic, the days spent in the hospital during the fight against Covid 19 and the period after. Vetton Pehlivani, Operations Manager at KEDS describes the 18-month journey in three acts.

Everyone has their own story about the Covid 19. Also Vetton Pehlivani, Manager in the Operations Division at KEDS has his own.

He tells the entry into the difficult period during the beginning of last year by an unknown virus that was challenging the entire globe.

"While the pandemic was spreading, I was very worried about my family. But, the big concern was also the fact that the workers I have under management had to go out on the field. In those situations, when the whole world was confused and did not know how to act, the worries only grew. What will happen, how to do the best for our workers", Vetton recalls that period.



Ishte marsi i viti 2020 kur pandemia po i afrohej Kosovës. Pikërisht disa ditë pa u lajmëruar rasti i parë, KEDS krijoi Komisionin për Menaxhimin e Krizës së Pandemisë. Vetoni ishte pjesë e tij.

“Ndërmorëm të gjitha masat në bazë të rekomandimeve të IKSHP-së dhe Qeverisë së Kosovës. Fatmirësisht, muajt e parë nuk e kishim asnjë infektim të vetëm”, thotë ai.

Vetoni çdo ditë ishte në terren me punëtorët. “Ishte periudhë me shumë të panjohura. Duhej të isha afër punëtorëve dhe kështu bëra. S’mund të veproja ndryshe”. Pandemia po merrte hov. Fatkeqësisht preku një pjesë të madhe të popullatës në dy valët e para. Po infektoheshin mijëra veta çdo ditë, përderisa Vetoni, ishte në krye të detyrës çdo ditë, duke bërë maksimumin që pandemia ta prekë sa më pak kompaninë.

Ishte vala e fundit, ajo në shkurt të këtij viti, kur Vetoni filloi të kishte lodhje. “Fillimisht mendova që e kam nga lodhja, ngase nuk e kisha asnjë simptomë gripale. Dhimbjet e trupit filluan të rëndoheshin, ndërsa bashkë më to edhe lodhja. Shkova ta bëj testin dhe dola pozitiv. Sigurisht nuk ishte ndjenjë aspak e mirë,” thotë Vetoni.

Virusi nuk po e mundonte aq dhe mendoi se do ta kalonte pa ndonjë problem. Por nuk doli ashtu. “Dhimbjet u rënduan tutje, shkova në Institut. Më rekomanduan shtrim urgjent në spital, në Infektivë”, tregon Vetoni, teksa gjendja kishte filluar t’i rëndohej.

It was March 2020 when the pandemic was getting close to Kosovo. A few days before the first case was announced, KEDS set up the Pandemic Crisis Management Commission. Veton was part of it.


“We took all measures based on the recommendations of the NIPH (National Institute of Public Health) and the Government of Kosovo. “Fortunately, in the first months we did not have a single infection,” he said.

Veton was on the field with the workers every day. “It was a period with many unknowns. I had to be close to the workers and so I did. I could not do otherwise. “The pandemic was on the rise. Unfortunately it affected a large part of the population in the first two waves. Thousands were being infected every day, while Veton was on duty every day, doing his best to make the pandemic affect the company as little as possible.

It was the last wave, February of this year, when Veton began to have fatigue. “At first I thought I had it because I was tired, because I did not have any flu symptoms. The body aches started to get worse, and with them the fatigue. I went to do the test and it came out positive. “It certainly wasn’t a good feeling at all,” says Vetoni.

The virus was not bothering him so much and he thought he would get over it without any problem. But it did not turn out that way. “The pain got worse, I went to the Institute. “They recommended me to be hospitalized urgently, in Infectious Diseases Clinic”, Vetoni says, as his condition had started to worsen.





Aty ai qëndroi 6 ditë në terapi intensive. “Jam 50-vjeçar, por nuk isha shtri më herët asnjëherë në spital. Ato ishin 6 ditët më të gjata dhe më të rënda të jetës time. Brengosësia shumë për familjen, pasi të gjithë ishin të infektuar, edhe pse nuk kishin shenja të rënda, ndërsa ata edhe më tepër për mua. Fatmirësisht, falë terapisë dhe kujdesit të madh të stafit, pas 1 jave u përmirësua dukshëm. Më liruan nga aty”.

Vetoni më pas mori terapi edhe një javë tjetër në shtëpi, ku u shërua plotësisht. Pas dy javësh u rikthye në punë.

“Me t’u rikthyer, dola sërisht në terren me punëtorët. Doja të isha me ta. U gëzuan shumë kur më panë në këmbë”, tregon ai.

Me rikthimin e tij, Vetoni vazhdoi ta japë kontributin e vet të pakursyer për kompaninë dhe kolegët e tij. Ai në fillim të gushtit edhe u vaksinua. “E mora vaksinën që të jap mesazh të gjithë. Ajo mbron jetën tuaj, të familjes tuaj dhe të kolegëve tuaj. Vaksinohuni që shpëtoni jetë, që të jemi më të lirë”, është mesazhi i tij.

Vetoni vazhdon në normalitetin e detyrave të tij në punë, me kujdes të shtuar për veten dhe kolegët në kushte pandemie.

He was hospitalised for 6 days in intensive therapy. "I am 50 years old, but I have never been hospitalized before. Those were the 6 longest and hardest days of my life. I was very worried about the family, as everyone was infected, even though they had no serious signs, while they were even more worried for me. Thankfully, thanks to the therapy and the great care of the staff, after one week I improved significantly and I was released from the hospital."

Vetoni then received therapy for another week at home, where he recovered completely. After two weeks he returned to work.



"When I returned, I went out on the field again with the workers. I wanted to be with them. They were very happy when they saw me on my feet," he said.

Upon his return, Vetoni continued to give his unstinting contribution to the company and his colleagues. He was vaccinated in early August. "I got the vaccine to give a message to everyone. It protects the lives of you, your family and your colleagues. Vaccinate to save lives, to be free," is his message.

Vetoni continues to normality with his duties at work, with added care for himself and colleagues in pandemic conditions.

**“E mora vaksinën që të jap mesazh te të gjithë.
Ajo mbron jetën tuaj, të familjes tuaj dhe të
kolegëve tuaj. Vaksinohuni që shpëtoni jetë,
që të jemi më të lirë.”!**

***"I got the vaccine to give a message to
everyone. It protects your life, the life of your
family and that of your colleagues. edhe me
hek presjen pas freer"!***



ATY KU NIS GJITHÇKA

WHERE IT ALL STARTS



Rrugëtimi i një pune padyshim që është shumë i rëndësishëm që rezultati të jetë ashtu siç duhet. Që edhe shtëpitë tona të jenë të ndriçuara duhet punë dhe motor i pa-ndalur i një zinxhiri të gjatë, pjesë e të cilit janë shumë punëtorë të kompanisë, puna e të cilëve bën që energjia elektrike të arrijë në secilën lagje e shtëpi.

The journey of a job is definitely very important for the result to be as it should be. For our homes to be illuminated it takes effort and the unstoppable engine of a long chain, part of which are many workers of the company, whose work makes electricity reach every neighbourhood and house.

Drenusha Gashi, Relay Protection and Scada engineer, briefly tells us about the work she does and the challenges she faces.

"Scada is a system that monitors in real time the network and all substations of medium voltage level," she said, which on daily bases follows the flow of all events that occur on the ground, respectively in substations, and as a result all work within the department is coordinated.

Despite this, she points out that coordinating with field workers is not at all difficult, because they are familiar with the nature of the work and are ready at any time.

Jeton Krasniqi, another example of KEDS, who never stops in work engagement. Jeton is the coordinator for New Connections. In addition to the administrative work, he also



Drenusha Gashi

Drenusha Gashi, inxhinierë e Mbrojtjes Rele dhe SCADA, na tregon shkurtimisht për punën që bën dhe sfidat me të cilat përballlet.

“SCADA është sistem që në kohë reale bën monitorimin e rrjetit dhe të gjitha nënstacioneve të nivelit të tensionit të mesëm,” thekson ajo, e cila çdo ditë është në rrjedha të të gjitha ngjarjeve që ndodhin në terren, respektivisht në nënstacione, dhe si rrjedhojë e kësaj koordinohen të gjitha punët brenda departamentit.

Përkundër kësaj, ajo tregon se koordinimi me punëtorët e terrenit nuk është fare i vështirë, për shkak se ata janë të njoftuar me natyrën e punës dhe janë të gatshëm në çdo kohë.

Jeton Krasniqi është një tjetër shembull i KEDS-it, i cili nuk ndalet së angazhuari.


Jetoni është koordinator i Lidhjeve të Reja. Përpos punës administrative që bën, ai merret edhe me urdhëresat për Lidhje të Reja, në bazë të paraqitjes së tyre nga konsumatorët. Në Distriktin e Prishtinës kanë të angazhuar 5 ekipe për pranimin e lidhjeve të reja, me të cilat merret ai dhe departamenti në të cilin bën pjesë.

Arsyet për të cilat i duhet që edhe ai vetë kohë pas kohe të jetë në terren, janë të shumta, duke filluar nga problemet pronësore, ndodh që konsumatori në fillim të mos pajtohet me procedurat e lidhjeve të reja, etj. Ndodh që ndonjë punë të ketë nevojë për ndërmjetësim për të përfunduar ashtu siç duhet.

Ndër rastet e shumta gjatë punës, Jetoni veçon një prej tyre:

“Një rast që vlen të veçohet, është kur në natën e ndërrimit të moteve (Viti i Ri 2021) bashkë me ekipin, për shkak të djegies së njehsorëve në një objekt banesor, kemi punuar me orë të tëra vetëm që t’ua kthejmë ndriçimin banorëve,” shprehjet Krasniqi.

Sidorela Dodaj, inxhinierë për Planifikim në Departamentin e Investimeve ka qenë pjesë e KEDS Academy, gjenerata e katërt dhe që nga ajo



Jeton Krasniqi

deals with orders for New Connections, based on submissions by customers. In the District of Prishtina are engaged 5 teams for the acceptance of new connections, which he deals with and the department in which he belongs.

The reasons why he himself needs to be in the field from time to time are many, starting from property issues, customers not agreeing with the procedures of new connections, etc. It happens that some work needs mediation to finish properly.

Among many cases during work, Jeton highlights one of them:

"A case worth noting is when on the night of the change of seasons (New Year 2021) together with the team, due to the burning of electric meters in a residential building, we worked hours and hours only to return the lighting to the residents", says Krasniqi.

Sidorela Dodaj, Planning Engineer in the Investment Department has been part of KEDS Academy, the fourth generation and since then is part of the company.

Undoubtedly, the department she belongs to is of great importance, considering that this is where it all begins. Together with the rest of the



Sidorela Dodaj

kohë është pjesë e kompanisë.

Pa dyshim që departamenti në të cilin bën pjesë është i një rëndësie të madhe, duke marrë parasysh se pikërisht aty fillon gjithçka. Bashkë me pjesën tjetër të departamentit ata merren me fazën e parë të një projekti, që nënkupton se kur vendoset të bëhet një investim, janë po ata që bëjnë planifikimin dhe dizajnimin e tij. Në kuadër të kësaj bëhen planifikimet e nevojshme teknike, që të dalin rezultate të mira në fund, dhe që konsumatorëve t'u ofrohet një furnizim sa më stabil dhe të qëndrueshëm me energji elektrike.

Sidorela thekson vazhdimisht për përgjegjësitë që bartë ky departament.

“Të gjithë bashkë përpiqemi vazhdimisht që konsumatorët të kenë sa më pak humbje në energji, tension sa më të mirë deri te konsumatori i fundit, si dhe dizajnim të rrjetit sa më të thjeshtë për operim e sa më të sigurt për përdorim”, thotë ajo.

Në anën tjetër Ali Ibishi, menaxher i Mirëmbajtjes, përmend sfidat që shfaqen gjatë realizimit të punëve në terren, që mund të jenë nga më të ndryshmet, siç bie fjala infrastruktura ekzistuese, pengesat e konsumatorëve, etj, por që me punë dhe përkushtim të gjitha këto gjejnë mirëkuptim.

department they deal with the first phase of a project, which means that when an investment is decided to be conducted, they are the ones who prepare planning and design. Within this, the necessary technical planning is done, in order to get good results in the end, and to offer the customers a more stable and quality energy supply.

Sidorela constantly emphasizes the importance of this department along with the responsibilities it carries. All together constantly strive for customers to have as little energy loss, the best possible voltage to the end customer and network design as simple as possible to operate and as safe to use.

*On the other hand, **Ali Ibishi**, maintenance manager, mentions the challenges that appear during the implementation of field work, which can be of various types, such as existing infrastructure, customer barriers, etc., but with work and dedication all these find understanding.*

"I would like to emphasize the company's commitment to the realization of investments and the extraordinary commitment that every request from the customer is addressed as soon as possible," says Ibishi.

In addition to the obstacles that may appear during the implementation of projects it is worth noting that in every project most customers welcome us and are thankful to KEDS, as in every project where it is being invested the network is fixed and is closely related to human well-being.

Hajdin Zhdrella, network manager, constantly emphasizes the readiness of the Operations Department, of which he is a part.

"The teams are always prepared 24/7 and work in three shifts, being prepared both in terms of work and in terms of protection and security, which is very important for us", he says.

Zhdrella mentions the importance of better coordination to have a better result in the end. Coordination should not be good only

“Unë do veçoja përkushtimin e kompanisë në realizimin e investimeve dhe në përkushtimin e jashtëzakonshëm që çdo kërkesë që vjen nga konsumatori të trajtohet në afatin sa më të shpejtë”, thotë Ibishi.

Përpos pengesave që mund të shfaqen gjatë implementimit të projekteve, vlen të theksohet se në çdo projekt shumica e konsumatorëve i presin mirë zyrtarët e KEDS dhe falënderojnë kompaninë, pasi që në çdo projekt ku është duke u investuar po rregullohet rrjeti, gjë që është e lidhur ngushtë me mirëqenien njerëzore.

Hajdin Zhdrella, menaxher i Rrjetit, vazhdimisht potencon gatishmërinë që ka Departamenti i Operimeve, pjesë e të cilit është.

“Ekipet janë gjithmonë të përgatitur 24/7 dhe punojnë me tri ndërrime, duke qenë të përgatitur edhe në pjesën e punëve edhe në aspektin e mbrojtjes dhe sigurisë, gjë që është shumë me rëndësi për ne”, thotë ai.

Zhdrella përmend rëndësinë e koordinimit sa më të mirë për të arritur një rezultat sa më të mirë në fund. “Koordinimi nuk duhet të jetë i mirë jo vetëm në mes të punëtorëve të terrenit dhe atyre të zyrave, por edhe me komuna dhe palë të tjera që rezultati të jetë sa më i mirë”, thotë ai.

Duke marrë parasysh që ndonjëherë ndodhin prishje ose avari në një vend të caktuar, Zhdrella tregon që së pari duhet konfirmimi nga komuna për secilin rast që pastaj KEDS të fillojë punimet. Duke mos dashur që konsumatorët të mbesin keq për energji elektrike, kompanisë i ka ndodhur t’i fillojë punimet ende pa e marrë përgjigjen për konfirmim nga palët e tjera, vetëm e vetëm që konsumatorëve sa më parë t’iu kthehet furnizimi me energji elektrike.

Gjatë bisedës, ai gjithashtu shpjegon se punën që bën nuk e sheh vetëm si punë, por më shumë si mision, pasi siç thotë ai bartë me vete një përgjegjësi të madhe, dhe për të është e rëndësishme që konsumatori të furnizohet me energji në çdo kohë.



between field and office workers, but also with municipalities and other parties for the result to be as good as possible.

Considering that sometimes blackouts or failures occur in a certain place, we first need confirmation from the municipality for each case so that KEDS can start the works. Not wanting the customers to be left in bad situation due to the lack of electricity, we as a company happened to start the works prior to receiving the answer for confirmation from the other parties, with the aim to return the electricity supply to the customers as soon as possible.

During the conversation, Zhdrella says that the work he does is not seen only as work, but more as a mission, because as he says he carries with him a great responsibility, and for him it is important that the consumer is supplied with energy at all times.





Ali Ibishi

"Undoubtedly, the year 2020 will be remembered by everyone. The difficulties we faced have had consequences in many areas. Despite the fact that in that period almost everything was closed and non-functional, KEDS worked non-stop, knowing that the hospitals were full and the need for oxygen

“Padyshim që viti 2020 do të mbahet mend nga të gjithë. Vështirësitë me të cilat u përballëm kanë lanë pasojë në shumë fusha. Pavarësisht se në atë periudhë pothuajse gjithçka ishte e mbyllur dhe jo-funksionale, KEDS punonte pa u ndalur, duke e ditur se spitalet ishin plot dhe nevoja për oksigjen ishte shumëfish më e madhe se më herët. Sigurisht që prioritet i kompanisë sonë ishte që këto vende, ku në pyetje jeta e njerëzve, të jenë të furnizuar me energji 24/7, duke punuar e munduruar gjithmonë një opsion të dytë për furnizim, në rast se ndodhë ndonjë prishje,” shprehet ai.

Duhet theksuar mobilizimin e shtuar të kompanisë, sidomos për ngjarjet e ndryshme të rëndësishme në vend, për të cilat KEDS gjithmonë është në gatishmëri me ekipe shtesë, siç janë zgjedhjet, për të cilat kompania gjithmonë angazhon stafin anembanë Kosovës, vetëm që mos të ketë ndalje duke marrë parasysh ndjeshmërinë dhe rëndësinë që kanë proceset zgjedhore.

Për fund, punonjësit e KEDS inkurajojnë sa më shumë konsumatorët për bashkëpunim dhe informim më të mirë të dyanshëm, duke i kontaktuar dhe lajmëruar në numrin zyrtar të KEDS për shqetësimet e tyre. Duke folur për problemet e duke na informuar ata, na ndihmojnë shumë, dhe është në të mirë të përgjithshme për dy arsye: Që konsumatorëve t’iu kthehet energjia dhe ne të gjejmë sa më shpejt burimin e prishjes.



was many times greater than before. Of course, the priority of our company was that these places, on which people's lives depended, are supplied with energy 24/7, always working and enabling a second option for supply, in case of any breakdown."



Hajdin Zhdrella

It should be noted the increased mobilization in our company, especially for various important events in the country, for which KEDS is always on standby with additional teams, such as elections, for which the company always commits its staff throughout Kosovo, in order not to have outages given the sensitivity and importance that elections have as events.

Finally, KEDS employees encourage as many customers as possible for better cooperation and mutual information, by contacting and informing us on their concerns on the official KEDS number. Through communicating about issues and being informed by them, they help us a lot and it is in the common good for two reasons: That the energy is restored to the consumers and we find the cause of the breakdown way faster.



SHQIPTARËT E THANË FUQISHËM FJALËN E VET NË EURO 2020

ALBANIANS STRONGLY SAID THEIR WORD AT EURO 2020

Goli i Admir Mehmetit nga pika e bardhë e dërgoi Zvicrën në gjysmëfinale të Kampionatit Evropian Euro 2020 që u mbajt këtë verë. Ai gjuajti penalltinë e fundit ndaj kampionit të botës në fuqi, Francës, dukë e dërguar këtë të fundit në shtëpi. Ndërkohë, një gol i Shaqirit në pjesën e dytë barazoi rezultatin ndaj Spanjës dhe Zvicra për pak sa nuk e pa veten në gjysmëfinale. Kjo, pasi goli i tij, që ishte i treti në atë kampionat, ngjalli shpresat e zvicëranëve, të cilët u mposhtën vetëm me penallti.

Admir Mehmeti's goal from the penalty kick sent Switzerland to the semi finals of the Euro 2020 European Championship that was held this summer. He shot the final penalty kick against the reigning world champions, France, sending the latter home. Meanwhile, a goal by Shaqiri in the second half equalized the score against Spain and Switzerland almost did see themselves in the semifinals. This, as his goal, which was the third in that championship, raised the hopes of the Swiss, who were defeated only by penalty kick out.



Këta ishin vetëm dy nga nëntë shqiptarët të cilët ishin pjesë e Kampionatit Evropian nga dy kombëtare të ndryshme. Zvicra u përfaqësua me 3 futbollistë, ndërsa Maqedonia e Veriut me 6 sosh. Për Zvicrën luajtën futbollisti i Arsenalit Granit Xhaka si kapiten, futbollisti i Liverpoolit, Xherdan Shaqiri dhe ai i Wlosfburgut, Admir Mehmeti. Në listë ishin gjashtë shqiptarë: Visar Musliu (MOL Fehervar-Hungari), Egzon Bejtullai (Shkëndija nga Tetova), Ezgjan Alioksi (Leeds Utd - Anglia), Ferhan Hasani (Partizani nga Tirana), Arijan Ademi (Dinamo nga Zagrebi), Enis Bardhi Levate - Spanjë).

Pra, në Euro 2020 ishin pothuajse një ekip shqiptarësh, edhe pse dy përfaqësueset kryesore të shqiptarëve, përkatësisht ajo e Shqipërisë dhe Kosovës munguan.

Ata shkëlqyen, duke lënë gjurmë në këtë kampionat. Ishte Granit Xhaka ai që inspiroi fitoren e Zvicrës ndaj kampiones botërore. E Zvicra, që po humbiste 1-3 kishte nevojë për inspirim. E gjetën te kapiteni i tyre, një shqiptar nga Kosova me zemër të madhe.

These were just two of the nine Albanians who were part of the European Championship from two different national teams: Switzerland was represented with 3 players, while Northern Macedonia with 6 of them.

Arsenal footballer Granit Xhaka played for Switzerland as captain, Liverpool footballer Xherdan Shaqiri and Wlosfburg footballer Admir Mehmeti. The list included six Albanians Visar Musliu (MOL Fehervar-Hungary), Egzon Bejtullai (Shkëndija from Tetovo), Ezgjan Alioksi (Leeds Utd - England), Ferhan Hasani (Partizani from Tirana), Arijan Ademi (Dinamo from Zagreb), Enis Bardhi Levante - Spain).

So, at Euro 2020 there was almost an Albanian team, although the two main representatives of the Albanians, namely that of Albania and Kosovo were absent.

They excelled, leaving their mark on this championship. It was Granit Xhaka who inspired Switzerland's victory over the world champion. Switzerland, which was losing 1-3, needed inspiration.

Xhaka u shpall Njeriu i Ndeshjes dhe futbollisti me impaktin më të madh në një ndeshje të Evropianit të fundit.


Fatkeqësisht, u ndëshkua me karton të verdhë dhe nuk kishte mundësi paraqitje ndaj një tjetër ndeshje, ku Zvicra shkëlqeu ndaj Spanjës. Por, shiritin e kapitenit e mori shqiptari tjetër, Shaqiri duke shkëlqyer gjithashtu.

Përmbysi rezultatin, duke lënë botën e futbollit gojëhapur. Edhe shqiptarët që luajtën për Maqedoninë e Veriut lanë shpirtin në fushë. Ia zbardhën fytyrën një përfaqësuese që po merrte pjesë për herë të parë në një ngjarje të madhe futbolli.

They found inspiration in their captain, a Kosovo Albanian with a big heart.

Xhaka was named Man of the Match and the footballer with the biggest impact in a match of the last European championship. Unfortunately he got a yellow card and had no chance of appearing in the following match, where Switzerland excelled against Spain. And the captain's band was taken by the other Albanian, Shaqiri, who also excelled. Reversed the result, leaving the football world speechless. Also, the Albanians who played for Northern Macedonia left their souls on the field. They bravely represented a selection team who was participating in a major football event for the first time.





www.keds-energy.com
www.kesco-energy.com

/kedsenergy



/Kescoenergy

@kedsenergy



@energykesco